



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

MINISTRIA E EKONOMISË
KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 4395 Prot. Tiranë, më 10.07.2024

Nr. 8945/2 Prot. Tiranë, më 26.2.2024

UDHËZIMI PËRBASHKËT

Nr. 13, datë 10.07.2024

PËR

VITIN SHKOLLOR 2024–2025 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i këtij Udhëzimi është përcaktimi i masave dhe i veprimtarive që ndërmarrin institucionet e sistemit arsimor parauniversitar gjatë vitit shkollor 2024-2025.

Neni 2

Regjistrimi i nxënësve dhe pajisja me tekste shkollore

1. Regjistrimet dhe transferimet e nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar (IAP) të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me procedurat e përcaktuara në Urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023, të MAS-it, “Për miratimin e rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar”.

2. Drejtoritë e IAP-ve të afishojnë në vend të dukshëm listën e teksteve shkollore, ku shënohen: titulli, shtëpia botuese, çmimi i tekstit për çdo klasë, vendi ku do të shpërndahen tekstet dhe periudha e shpërndarjes sipas një grafiku për çdo klasë.
3. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, drejtuesit e IAP-ve dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi:
 - a) procesin e shpërndarjes dhe të shitjes së teksteve shkollore për të gjithë nxënësit para fillimit të procesit mësimor;
 - b) procesin e pajisjes me tekste shkollore falas dhe në përdorim falas për klasat I-IX të arsimit bazë, si dhe pajisjen me tekste shkollore falas të të gjitha kategorive të përcaktuara në VKM-në përkatëse.
4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) të raportojë zyrtarisht në MAS për ecurinë e procesit të pajisjes së të gjithë nxënësve me tekste shkollore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Ndalimi i përdorimit të telefonit celular

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare të marrin masa për zbatimin e Urdhrit nr. 493, datë 30.7.2018, të MASR-së, “Për mospërdorimin e telefonit celular gjatë procesit mësimor në shkolla” dhe të Udhëzimit nr. 34, datë 16.11.2018, të MASR-së, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare”.
2. Masat për ndalimin e përdorimit të telefonit celular gjatë procesit mësimor të pasqyrohen në rregulloren e brendshme të institucionit arsimor parauniversitar.

Neni 4

Shërbimi psiko-social (ShPS)

1. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) të marrin masa për funksionimin e shërbimit psiko-social, në zbatim të Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020, të MASR-së, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit nga shërbimi psiko-social”, i ndryshuar.
2. DRAP-të dhe ZVAP-të të monitorojnë zbatimin e planit të punës të njësive të ShPS-së dhe të raportojnë në AKAP, në muajt janar dhe qershor 2025, për realizimin e tij. AKAP-ja të raportojë në MAS në muajt shkurt dhe korrik 2025.
3. Puna e punonjësve të ShPS-së në institucionet e arsimit parauniversitar të mbështetet në “Manuali i punës për punonjësit e shërbimit psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar”, “Standardet e përgjithshme profesionale të shërbimit psiko-social shkollor”, “Parimet për etikën profesionale të shërbimit psiko-social shkollor”, të miratuara me shkresën e MAS-it nr. 2116/2 prot., datë 08.07.2022.

KREU II

VEPRIMTARIA NË INSTITUCIONET ARSIMORE PARAUNIVERSITARE

Neni 5

Arsimi parashkollor

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore (kopshtet), të ndjekin me përparësi detyrat si vijon:

- a) Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të jashtme e të brendshme të institucioneve arsimore parashkollore të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse, që të mundësojnë zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.
- b) Marrjen e masave për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve 3-6 vjeç në arsimin parashkollor.
- c) Regjistrimin me përparësi në institucionet arsimore parashkollore të fëmijëve me nevoja të veçanta: nga familjet në nevojë, nga pakicat kombëtare (romë, egjiptianë etj.) dhe fëmijë me aftësi të kufizuara.
- ç) Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi.
- d) Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga mësuesit e arsimit parashkollor në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale të specializuara.
- dh) Ngritjen në çdo institucion arsimor parashkollor të bordit, këshillit të prindërve, këshillit të mësuesve dhe komisionit të etikës e sjelljes, sipas legjislacionit në fuqi.
- e) Trajtimin me përparësi nga këshillat e mësuesve dhe nga rrjetet profesionale të temave të mëposhtme:
 - i) Standardet e zhvillimit dhe të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç.
 - ii) Kurrikula me kompetenca dhe planifikimi sipas saj në arsimin parashkollor.
 - iii) Portofoli i të nxënit.
 - iv) Korniza e vlerësimit në arsimin parashkollor.
 - v) Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor.
 - vi) Standardet profesionale për drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore.
 - vii) Arsimi gjithëpërfshirës.
 - viii) Mësimdhënia me fëmijën në qendër.
 - ix) Ndërgjegjësimi i prindërve për rëndësinë e frekuentimit të kopshtit nga fëmijët e moshës 3-6 vjeç.
 - x) Zhvillimi profesional i mësuesit dhe i drejtuesit të institucionit arsimor parashkollor, faktor në rritjen e cilësisë së shërbimeve për fëmijët 3-6 vjeç.
- ë) Zbatimin e Urdhrit nr. 199, datë 07.05.2024, të MAS-it, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit” dhe të “Udhëzuesit metodologjik për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të kopshtit”.

Neni 6 Arsimi bazë

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare, të ndjekin me përparësi:

- a) Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të jashtme dhe të brendshme për një shkollë miqësore, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse, të cilat nxisin edukimin dhe krijimin e një raporti të qëndrueshëm me mjedisin dhe natyrën.
- b) Regjistrimin me përparësi të fëmijëve nga shtresat në nevojë, pakica kombëtare, me aftësi të kufizuara, të kthyer nga emigracioni, të fëmijëve viktimë apo viktimë të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore etj.
- c) Zbatimin e Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023, të MAS-it, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- ç) Zbatimin e planeve mësimore për klasën e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt, miratuar me Urdhrin nr. 203, datë 25.04.2023.
- d) Zbatimin e planit mësimor për klasat V-IX, sipas shtojcës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi.
- dh) Zbatimin e planit mësimor për pakicat kombëtare në arsimin bazë, miratuar me Urdhrin nr. 531, datë 09.09.2022.
- e) Zbatimin e planit mësimor për Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë, të rishikuar, konfirmuar nga MAS-i, me shkresë nr. 7254/1 prot., datë 10.11.2022, në kuadër të përfshirjes së lëndës së gjuhës angleze dhe të lëndës së TIK-ut që në klasën e parë të shkollave të arsimit bazë.
- ë) Zbatimin e planit mësimor për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, miratuar me Urdhrin nr. 694, datë 18.11.2022.
- f) Zbatimin në shkollat e pajisura me Smartlab të programit mësimor të lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasën e parë, miratuar me Urdhrin nr. 304, datë 10.06.2022.
- g) Zbatimin në shkollat e pajisura me Smartlab të programit mësimor të lëndës së TIK-ut për klasën e dytë, të miratuar me shkresën nr. 2608/2, datë 08.05.2023.
- gj) Zbatimin e planit mësimor të klasave të caktuara me drejtim artistik në arsimin bazë, miratuar me Urdhrin nr. 305, datë 16.06.2023.
- h) Zbatimin e planit mësimor për arsimin bazë me kohë të pjesshme, miratuar me Urdhrin nr. 284, datë 28.07.2021.
- i) Zbatimin e planit mësimor të shkollave speciale miratuar me Urdhrin nr. 366, datë 21.09.2021.
- j) Zbatimin e programit kombëtar për aktivitete jashtë orarit mësimor, “Art, Zeje, Sport”, miratuar me VKM-në nr. 606, datë 14.09.2022, të ndryshuar, në ato IAP që janë pjesë e këtij programi.
- k) Zbatimin e Urdhrit nr. 600, datë 19.10.2023, të MAS-it, “Për miratimin e udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9)” dhe raportimin nga AKAP-ja në MAS për ecurinë e orientimit për karrierën, brenda datës 01.07.2025.

- l) Zbatimin e Urdhrit nr. 267, prot., datë 3.6.2024 “Për miratimin e programit mësimor të lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasën e tretë”.
- ll) Zbatimin nga institucionet arsimore të planit të veprimit të hartuar prej tyre (DRAP/ZVAP) për mbështetjen e arsimit në gjuhën amtare të fëmijëve të pakicave kombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- m) Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive të veçanta në institucionet publike të arsimit parauniversitar ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave kombëtare.
- n) Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- nj) Ndjekjen dhe përfundimin e arsimit bazë nga fëmijët romë, sipas deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për romët.
- o) Raportimin në AKAP dhe në MAS, brenda afateve dhe kërkesave, të të dhënave statistikore në arsimin bazë, sipas pasqyrave të miratuara nga INSTAT-i.
- p) Funksionimin e rrjeteve profesionale të mësuesve, mësuesve ndihmës, mësuesve që japin mësim në klasat kolektive dhe të shërbimit psiko-social.
- q) Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe të provimeve kombëtare të arsimit bazë, në zbatim të udhëzimeve dhe rregulloreve përkatëse.
- r) Trajnimin e rrjeteve profesionale të mësuesve të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave të natyrës, si dhe organizimin e veprimtarive për përgatitjen e nxënësve për vlerësimet ndërkombëtare PISA, PIRLS dhe TIMSS.
- rr) Koordinimin dhe realizimin e veprimtarive për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet ndaj përmbajtjeve të paligjshme dhe të dëmshme dhe parandalimin e dukurive negative në shkollë, në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të MAS-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) me nr. 658, datë 23.09.2019, “Për procedurat dhe veprimet që ndërmarrin strukturat arsimore në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në rastet kur në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, konstatohet se një fëmijë është duke aksesuar në internet përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme për moshën e tij”.
- s) Sigurimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme.
- sh) Zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”, me vendimmarrje të vetë shkollës, në varësi të kushteve dhe specifikave të saj.
- t) Zbatimin e veprimtarive në përputhje me urdhrin nr. 65 datë 13/02/2024 “Për realizimin e planit të aktiviteteve në kuadër të programit *e-twinning*, për periudhën 2024-2026, në përputhje me kushtet e marrëveshjes”.
- th) Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive për parandalimin e dhunës në shkollë dhe raportimin periodik të çdo shkolle në ZVAP, DRAP, AKAP dhe MAS.
- u) Planifikimin dhe realizimin e veprimtarive që synojnë përgatitjen e nxënësve të klasave të nënta për Konkursin Kombëtar të Gjuhës Shqipe.
- v) Zhvillimin e veprimtarive brenda dhe jashtë klasës që synojnë njohjen dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në procesin mësimor.
- x) Mësimin e gjuhëve të huaja në arsimin bazë:
 - i) Të sigurohet, brenda shkollës, vijimësia e gjuhës së huaj të parë, të nisur në klasën e parë të arsimit fillor, dhe të gjuhës së huaj të dytë, të nisur në klasën VI.
 - ii) Të zbatohen memorandumet dhe marrëveshjet dypalëshe si vijon:

- iii/1) Për gjuhën italiane, vijon zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit miratuar më 18.05.2021 për programin “Iliria”. Planifikimi i shkollave që do të zhvillojnë gjuhën italiane, është kompetencë dhe përgjegjësi e ZVAP-ve.
- iii/2) Për gjuhën frënge, vijon zbatimi i angazhimeve në kuadër të aderimit në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe të Memorandumit të Partneritetit mbi “Bashkëpunimin Arsimit të Kuadrit Strategjik të Frankofonisë”.
- iii/3) ZVAP-të Elbasan, Durrës, Korçë-Pustec, Shkodër dhe Tiranë, në shkollat e të cilave funksionojnë klasat mbështetëse për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, shqiptaro-franceze dhe shqiptaro-gjermane, të sigurojnë hapjen e klasave në shkollat e përcaktuara në memorandume, duke filluar në klasën III të arsimit fillor dhe në klasën VI të arsimit të mesëm të ulët për fazën tranzitore.
- iii/4) DRAP-të, për çdo ZVAP në varësi, të raportojnë planifikimin për secilën gjuhë të huaj në AKAP e cila, brenda datës 30 shtator 2024, raporton në MAS.
- xh) Zbatimin e Urdhrit të përbashkët nr. 3348/1, datë 18.04.2018, të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”.
- y) Zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe raportimin çdo tre muaj nga AKAP-ja në MAS për ecurinë e kësaj nisme.
- z) Krijimin e klasave të profilizuara në sport në disiplina të ndryshme sportive, sipas kërkesave të nxënësve, vetëm në fillim të vitit shkollor dhe pas miratimit nga DRAP-ja.
- zh) Krijimin e klasave të arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë në zbatim të Udhëzimit nr. 21, datë 8.9.2023, të MAS-it, “Për përcaktimin e rregullave dhe proceduarve për krijimin e klasave të arsimit të orientuar në shkollat e arsimit bazë”.

Neni 7

Arsimi i mesëm i lartë

- I. Për gjimnazet, DRAP-të, ZVAP-të dhe drejtuesit e gjimnazeve të ndjekin me përparësi:
 - a) Marrjen e masave për krijimin e një mjedisi të jashtëm dhe të brendshëm për një shkollë miqësore, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse dhe të një raporti të ri dhe të qëndrueshëm me mjedisin dhe natyrën.
 - b) Zbatimin e programit kombëtar për aktivitete jashtë orarit mësimor, “Art, Zeje, Sport”, miratuar me VKM-në nr. 606, datë 14.09.2022, të ndryshuar, në ato IAP që janë pjesë e këtij programi.
 - c) Zbatimin e Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023, të MAS-it, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”.
 - ç) Zbatimin e planeve mësimore si më poshtë:
 - i) Plani mësimor i gjimnazit, i miratuar me shkresën nr.12789/1 prot., datë 28.12.2017.
 - ii) Plani mësimor i gjimnazit me kohë të pjesshme, i miratuar me shkresën nr.7380 prot., datë 20.07.2016.

- iii) Plani mësimor për arsimin e mesëm të lartë të orientuar “Teknologji dhe TIK” për nxënësit që nuk dëgjojnë, miratuar me Urdhrin nr. 113, datë 27.02.2023.
 - d) Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi.
 - dh) Koordinimin në zbatim të marrëveshjes mes MAS-it dhe Komisionit European për programin *e-twinning* dhe programin Erasmus+ për arsim dhe edukim, sipas urdhrin nr. 65 datë 13/02/2024, “Për realizimin e planit të aktiviteteve në kuadër të programit *e-twinning*, për periudhën 2024-2026”.
 - e) Regjistrimin me përparësi të nxënësve nga pakica rome dhe egjiptiane dhe përfundimin prej tyre të arsimit të mesëm të lartë sipas deklaratës së partnerëve të Ballkanit Perëndimor për romët.
 - ë) Raportimin në AKAP dhe MAS, brenda afateve dhe kërkesave, të të dhënave statistikore në gjimnaze, sipas pasqyrave të miratuara nga INSTAT-i.
 - f) Zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore bazuar në rregulloren e Maturës Shtetërore dhe udhëzimet përkatëse.
2. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me orientim gjuhësor të merren masat e mëposhtme:
- a) Të zbatojnë planin mësimor të miratuar me shkresën nr. 5415 prot., datë 26.05.2016.
 - b) T’i zgjedhin vetë tekstet shkollore për lëndën e gjuhës së huaj, nëse ato që janë në katalogun e teksteve shkollore 2024-2025, nuk përmbushin kërkesat kurrikulare të kësaj lënde.
3. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë të orientuar të merren masat për zbatimin e akteve të mëposhtme:
- a) Plani mësimor për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me drejtim artistik, miratuar me Urdhrin nr. 306, datë 16.06.2023.
 - b) Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive), shkolla “Loro Boriçi”, i miratuar me shkresën nr. 5418 prot., datë 26.05.2016.
 - c) Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (sportive), shkolla “Benardina Qerraxhia”, i miratuar me shkresën nr. 4116/1 prot., datë 11.09.2020.
4. Për institucionet e arsimit të mesëm të lartë me seksione shkollore dygjuhëshe të merren masat për zbatimin e akteve të mëposhtme:
- a) Marrëveshja nr. 6045 prot., datë 13.06.2016, midis ministrisë përgjegjëse për arsimin të Republikës së Shqipërisë dhe ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe zhvillimin ndërkombëtar të Republikës së Francës mbi “Bashkëpunimin në fushën e arsimit dygjuhësh”;
 - b) Memorandumi i Mirëkuptimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë mbi funksionimin e seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-italiane, nënshkruar më 12.12.2019;
 - c) Memorandumi i Bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë mbi seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman dhe planet mësimore për seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman, miratuar me shkresën nr. 7496 prot., datë 22.07.2016.

5. Për institucionet e arsimit të mesëm profesional të zbatohen:
 - a) Urdhri nr. 281, prot., datë 6.6.2024, “Për miratimin e planeve mësimore të kulturës së përgjithshme për arsimin e mesëm profesional” .
 - b) Fusha e kulturës profesionale në arsimin e mesëm profesional, për vitin shkollor 2024-2025, rregullohet me akte të posaçme në përputhje me ligjin nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - c) Për Maturën Shtetërore Profesionale të zbatohet rregullorja e zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore, përfshirë dhe Maturën Shtetërore Profesionale dhe udhëzimet përkatëse, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.
6. Për arsimimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur të zbatohet Urdhri i përbashkët nr. 3348/1, datë 18.04.2018, i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për rregullimin e procesit arsimor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur”.

Neni 8

Arsimi parauniversitar privat

1. DRAP-të dhe ZVAP-të të realizojnë me përparësi detyrat si vijon:
 - a) Të mbajnë kontakte me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat, t'i informojnë rregullisht për çdo ndryshim apo akt të ri ligjor dhe nënligjor në fushën e arsimit dhe t'i monitorojnë për realizimin e planeve dhe të programeve mësimore.
 - b) Të kërkojnë dhe të administrojnë të dhëna statistikore që lidhen me procesin mësimor.
 - c) Të bëjnë vlerësimin e kritereve të licencimit dhe ushtrimit të veprimtarisë për çdo institucion arsimor dhe të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MAS.
 - ç) Të sistemojnë nxënësit, në rast mbylljeje të institucioneve arsimore private.
2. Institucionet arsimore parauniversitare private të marrin masat e mëposhtme:
 - a) Të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në fillim të vitit shkollor, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve, sipas statistikave të miratuara, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe planin vjetor të shkollës sipas formatit të parashikuar në rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;
 - b) Të zbatojnë rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, për transferimin e nxënësve, si dhe Udhëzimin nr. 28, datë 16.10.2023, “Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas”.
 - c) Të realizojnë detyrimet e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit (regjistra, amza, evidenca për lëvizjet e nxënësve, rregullore e brendshme e kopshtit/shkollës, dëftesa, kontrata me prindërit etj.), sipas Udhëzimit nr. 15, datë 12.07.2013, të MASH-it, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar;
 - ç) Institucionet mund ta ndërpresin veprimtarinë e tyre arsimore vetëm në fund të vitit shkollor. Për mbylljen e veprimtarisë arsimore duhet të njoftojnë institucionet arsimore

vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, AKAP-në, MAS-in, Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e plotë në ZVAP-të përkatëse.

3. Institucionet arsimore parauniversitare private ku mësimi zhvillohet në gjuhë të huaj, të bashkëpunojnë me ZVAP-të përkatëse për njoftimin në kohë të maturantëve të cilët dëshirojnë të vijojnë studimet e larta në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e procedurave të përcaktuara në rregulloren e Maturës Shtetërore të vitit përkatës.

KREU III POLITIKA, STRATEGJI, MARRËVESHJE

Neni 9

Reduktimi i braktisjes shkollore

1. Për reduktimin e braktisjes shkollore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare të zbatojnë me përgjegjësi:
 - a) Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet MAS-it, MShMS-së dhe Ministrisë së Brendshme (MB), nr. 7522 prot., datë 12.7.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore”;
 - b) Urdhrin e përbashkët nr. 292, datë 28.05.2019, të MAS-it, MB-së dhe MShMS-së, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor””.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:
 - a) të monitorojnë shkollat lidhur me raportimin e nxënësve braktisës dhe të atyre në rrezik braktisje;
 - b) të koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve pranë bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile për zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës dhe të fëmijëve në situatë rruge;
 - c) të ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve të ngujuar dhe zbatimin e procedurave të ndjekjes së arsimit bazë, sipas udhëzimit përkatës për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë;
 - ç) të raportojnë në DRAP dy herë në vit (në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor) punën e bërë për reduktimin e braktisjes shkollore. DRAP-të të raportojnë në AKAP, e cila përcjell raportin në MAS.

Neni 10

Organizimi dhe zhvillimi i praktikave profesionale

1. Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, DRAP-të, ZVAP-të dhe institucionet arsimore të zbatojnë Urdhrin nr. 100,

datë 25.02.2022, të MAS-it, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar.

2. DRAP-të dhe ZVAP-të:
 - a) Publikojnë në faqen e internetit listën e institucioneve arsimore parauniversitare, publike dhe private, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale.
 - b) Hartojnë listat e IAP-ve, publike dhe private, në juridiksion, në të cilat do të zhvillohet praktika profesionale, listat e praktikantëve dhe listat e mentorëve.
 - c) Sigurojnë kryerjen e praktikës profesionale nga praktikantët, sipas procedurave të rregullores së praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.
 - ç) Monitorojnë organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në IAP, publike dhe private.

Neni 11

Shkolla qendër komunitare

1. Konsolidimi i shkollave qendra komunitare (ShQK), bazuar në standardet e shkollës si qendër komunitare në këto aspekte:
 - a) ShQK-të të vlerësohen për përmbushjen e standardeve dhe kritereve të përcaktuara për ShQK-në.
 - b) Shkollat, pjesë e programeve të bashkëpunimit me partnerët Save the Children, World Vision, UNICEF, UNDP, të vijojnë të jenë pjesë e ShQK-së dhe të bashkëpunohet për përmbushjen e angazhimeve dypalëshe dhe të projekteve në proces.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:
 - a) të vlerësojnë ShQK-të në përputhje me kriteret;
 - b) të marrin masat e nevojshme për këshillimin, informimin, trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të mësuesve koordinatorë, strukturave të shkollës, grupimeve nga komuniteti, në bashkëpunim me ZVAP-të, DRAP-të, AKAP-në dhe Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe partnerët;
 - ç) të promovojnë praktikat më të mira të ShQK-ve dhe të shkëmbejnë përvojat mes shkollave;
 - c) të marrin masat për menaxhimin sa më efektiv të 10 orëve javore të planifikuara për ShQK-në;
 - d) të propozojnë në MAS për miratim shkolla të tjera që plotësojnë kriteret e ShQK-së.

Neni 12

Karta e Performancës

1. Për Kartën e Performancës të vitit shkollor 2023-2024 dhe për vitin shkollor 2024-2025:
 - a) në dërgimin e të dhënave që burojnë nga shkolla, të sqarohet edhe procedura e përpunimit të të dhënave siç është përcaktuar në udhëzuesin për Kartën e Performancës së shkollës;
 - b) institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mund të vendosin të kenë tregues rajonalë ose jo (p.sh.: të dhëna për lëndët me zgjedhje, arritjet e nxënësve me AK etj.);

- ç) çdo shkollë në arsimin parauniversitar, deri më 03.09.2024, të plotësojë Kartën e Performancës së shkollës për vitin shkollor 2023-2024, si dhe ta bëjë atë publike për prindërit dhe komunitetin;
- c) ZVAP-të të verifikojnë të dhënat e dërguara nga shkollat deri më 10.09.2024;
- dh) në fund të muajit shtator 2024, ZVAP-të të shpallin shkollat e suksesshme në zbatim të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare;
- e) shkollat të hartojnë Kartën e Performancës për vitin shkollor 2024-2025 me treguesit e përzgjedhur, bazuar në Urdhrin nr. 157, datë 28.3.2022, të MAS-it, “Për miratimin e Kartës së Performancës së Shkollës dhe udhëzuesit të saj”;
- ë) çdo shkollë e arsimit parauniversitar të llogarisë edhe ndryshimin në vlerë për treguesit e pasqyruar në Kartën e Performancës së vitit paraardhës.

Neni 13

Parandalimi i dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në institucionet arsimore

1. ZVAP-të dhe drejtoritë e IAP-ve të marrin masa për:
 - a) planifikimin vjetor të veprimtarive ndërgjegjësuere me fokus parandalimin dhe minimizimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në institucionet arsimore;
 - b) ngritjen e këndit “Stop dhunës në shkollë”;
 - c) ngritjen e ekipeve “antibulling” në çdo shkollë;
 - ç) monitorimin dhe përmirësimin e punës të komisioneve të disiplinës dhe të komisioneve të etikës dhe të sjelljes, për trajtimin e rasteve të çdo lloji dhune në institucionet arsimore;
 - d) organizimin e veprimtarive ndërgjegjësuere të datës 21 nëntor, “Ditës Kombëtare kundër bullizmit”;
 - dh) konsolidimin e rrjetit të mësuesve koordinatorë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në arsimin parauniversitar;
 - e) raportimin në DRAP, brenda datës 30.05.2025, sipas formateve të përcaktuara, të rasteve të dhunës në institucionet arsimore, të trajtuara nga komisionet e etikës, si dhe raportin informues për punën e bërë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve.
2. AKAP-ja, në bashkëpunim me ASCAP-in, harton raportin përmbledhës dhe e dërgon në MAS, brenda datës 01.07.2025.

Neni 14

Zbatimi i strategjive ndërsektoriale, planeve kombëtare të veprimit dhe projekteve

1. ASCAP-i, AKAP-ja dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në bazë të planit të veprimit për zbatimin e secilës strategji kombëtare ndërsektoriale:
 - a) të caktojnë personat përgjegjës;
 - b) të hartojnë plane pune vjetore me detyra dhe afate konkrete;
 - c) të monitorojnë realizimin e veprimtarive;
 - ç) të raportojnë rregullisht për përmbushjen e detyrimeve që lindin nga këto strategji.

2. ASCAP-i dhe AKAP-ja të mbështesin dhe të raportojnë në MAS ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre, për strategjitë, planet kombëtare dhe projektet e mëposhtme:
- a) Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 621, datë 22.10.2021.
 - b) Strategjia Kombëtare për Migracionin, 2024-2030 dhe Plan i Veprimit 2024-2026, miratuar me VKM-në nr. 271, datë 02.05.2024.
 - c) Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, plani i veprimit dhe pasaporta e indikatorëve, miratuar me VKM nr. 892, datë 27.12.2022.
 - d) Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023-2025 dhe Plan i Veprimit 2023-2025, miratuar me VKM-në nr. 81, datë 14.2.2023.
 - ç) Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plan i Veprimit 2020-2025, miratuar me VKM-në nr. 1034, datë 24.12.2020.
 - d) Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, miratuar me VKM-në nr. 659, datë 3.11.2021.
 - dh) Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026 dhe plani i veprimit 2021-2024, miratuar me VKM-në nr. 1139, datë 24.12.2020.
 - e) Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030 dhe plani i veprimit, miratuar me VKM-në nr. 400, datë 30.06.2021.
 - ë) Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2024 dhe plani i veprimit, miratuar me Vendimin nr. 47/2019 të Kuvendit të Shqipërisë.
 - f) Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, miratuar me VKM-në nr. 1140, datë 24.12.2020, i ndryshuar.
 - g) Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2024, miratuar me VKM-në nr. 1117, datë 16.12.2020.
 - gj) Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025 dhe plani i veprimit, miratuar me VKM-në nr. 903, datë 24.12.2019.
 - h) Plan i Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, miratuar me VKM nr. 276, datë 12.5.2021.
 - i) Plan i Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021-2025”, miratuar me VKM nr. 701, datë 18.11.2021.
 - j) Plan i Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit dhe plani i veprimit, miratuar me VKM-në nr. 412, datë 19.06.2019.
 - k) Projekti “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin e Europës dhe Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Ky projekt do të zbatohet në shkollat e përzgjedhura në bashkëpunim nga Këshilli i Europës dhe MAS-i.
 - l) Projekti “STEM” në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Fondacionit Vodafon Albania dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
 - ll) Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, për zbatimin e projektit “Element IT”, miratuar me VKM-në nr. 594, datë 07.09.2022.

- m) Projekti “Shkollat për shëndetin”, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, miratuar me VKM-në nr. 521, datë 18.09.2021.
- n) Projekti “QËNDRO” (Qëndroni në shkollë! Qëndroni në Shqipëri), në kuadër të bashkëpunimit me qeverinë italiane dhe UNICEF Shqipëri.
- nj) Projekti “Panairi shkencor”, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar midis MAS-it dhe ShUKALB-it.
- o) Projekti “Inteligjenca artificiale për të rinjtë”, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet MAS-it dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, me nr. 3877/1 prot., datë 03.06.2022.

Neni 15

Edukimi shëndetësor dhe mjedisor

1. DRAP-të, ZVAP-të dhe IAP-të të marrin masa për zbatimin me përparësi të:
 - a) Urdhrit të përbashkët nr. 335, datë 14.07.2021, midis MShMS-së dhe MAS-it për miratimin e rregullores “Për ndalimin e reklamimit të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”.
 - b) Urdhrit të përbashkët nr. 336, datë 14.07.2021, midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për miratimin e rregullores për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”.
2. DRAP-të, ZVAP-të dhe institucionet arsimore parauniversitare të sigurojnë:
 - a) që nxënësit e arsimit parauniversitar të mos ekspozohen ndaj reklamave të ushqimeve të pashëndetshme në mjediset e institucioneve arsimore,
 - b) mbrojtjen e shëndetit të nxënësve, informimin e tyre dhe kushtet higjienike të mjediseve,
 - c) zhvillimin e veprimtarive për ndërgjegjësimin e nxënësve për ushqyerjen e shëndetshme,
 - ç) zhvillimin në IAP të veprimtarive jashtëshkollore dhe plotësuese në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, Ditës Botërore të Ujit dhe Ditës Botërore të Tokës.
 - d) zbatimin e projekteve të organizatave, shoqatave dhe individëve me qëllim kultivimin e vlerave të qytetarisë dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve në mjedis për, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij,
 - dh) zbatimin e nismës “Toka në shkollë” për krijimin në të gjitha shkollat të miniparcelave (kopshte të gjelbra në shkollë),
 - e) zbatimin e projekteve “Miq të ujit” dhe “Sfida botërore e monitorimit të ujit”, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara midis MAS-it dhe ShUKALB-it.
 - ë) zbatimin e nismës “Miku i mjedisit” në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Bashkinë Tiranë, UNICEF dhe “Eco Tirana”.

Neni 16

Zbatimi i marrëveshjeve dhe memorandumeve

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të raportojnë në AKAP, e cila raporton në MAS, për ecurinë e zbatimit të masave në ngarkim të tyre për marrëveshjet dhe memorandumet e mëposhtme:

- a) Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1084 prot., datë 15.02.2023, ndërmjet MAS-it dhe Institutit për Studimin e Krimeve të Komunizmit, “Për koordinimin e veprimtarive të përbashkëta institucionale për informimin e nxënësve mbi krimet e komunizmit të kryera në Shqipëri gjatë periudhës 1944-1990”.
- b) Marrëveshja e Bashkëpunimit nr. 1646 prot., datë 18.03.2021 ndërmjet MAS-it dhe Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish Sigurimit të Shtetit, në kuadër të zbatimit të politikave arsimore dhe të formimit historik të nxënësve.
- c) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Botërore të Shahut, Federatës Shqiptare të Shahut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 4661/1, datë 18.06.2015, objekt i së cilës është implementimi i projektit “Mësime të shahut në shkolla”.
- ç) Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr. 1988/2, datë 14 prill 2021, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Albanian-American Development Foundation për zbatimin e programeve të “Junior Achievement of Albania”. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të koordinojë veprimtaritë që mundëson ky memorandum, duke u angazhuar në mbështetje të ekspertëve vendas dhe të huaj, të cilët do të zbatojnë aktivitetet e programeve të “Junior Achievement of Albania”.
- d) Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, “Për realizimin e olimpiadës së përbashkët në lëndën “Gjuhë shqipe”, klasa e 9-të, arsimit mesëm i ulët parauniversitar”.
- dh) Marrëveshja e Bashkëpunimit për Këshillimin e Karrierës për nxënësit e arsimit parauniversitar nr. 2996/2, datë 05.05.2022, midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë Tiranë.
- e) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Xhudos dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 9322, datë 12.11.2015, për zbatimin e projektit “Mësime të xhudos në shkolla”.
- ë) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Hendbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 4073, datë 18.04.2016, objekt i së cilës është zbatimi i projektit “Mësime të hendbollit në shkolla”.
- f) Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 1660, datë 12.12.2017, për zbatimin e projektit “Mësime të futbollit në shkolla (Grow 2020)”.
- g) Programi “Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”, sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Brendshme, nr. 7638, datë 16.04.2014, si dhe edukimi i të rinjve me parimet e fair-play (garimi i drejtë) dhe rreziqet e dopingut

- ndaj shëndetit, dëmi që shkakton ai në vlerat etike të sportit, në zbatim të ligjit nr. 9242, datë 17.06.2004, "Për ratifikimin e Konventës Europiane Anti-doping 1989".
- g) Marrëveshje Bashkëpunimi midis Federatës Shqiptare të Basketbollit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2028/1, datë 23.02.2018, për zbatimin e projektit "Mësime të basketbollit në shkolla".
 - h) Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Organizatës Kombëtare Antidoping dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", regjistruar në MAS me nr. 1155/1, datë 29.05.2023.
 - i) Memorandumi i Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Korpusit të Paqes, nënshkruar më datë 23.04.2024. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të informojnë institucionet arsimore që:
 - i) të përfshijnë vullnetarin/en në takimet e organizuara në shkollë për procesin e bashkëmësimdhënies dhe të projekteve të ndryshme në interes të shkollës;
 - ii) të mbështesin mësuesit të marrin pjesë në trajnimet që zhvillon/sponsorizon Korpusi i Paqes;
 - iii) të përfshijnë vullnetarin/en në organizimin dhe zbatimin e veprimtarive dhe të projekteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet;
 - iv) të mbështesin vullnetarin/en në zbatimin e nismës për të zhvilluar aftësitë në gjuhën angleze të mësuesve të lëndëve të tjera.
 - j) Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016, dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, "Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë", ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të koordinojë veprimtaritë kulturore, artistike, figurative që mundëson ky memorandum.

Neni 17

Veprimtari plotësuese dhe jashtëshkollore

1. Në zbatim të VKM-së, nr. 324, datë 29.05.2024, "Për miratimin e kalendarit të integruar të veprimtarive në kuadër të vitit mbarëkombëtar të 80-vjetorit të Çlirimit", institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe IAP-të të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë veprimtaritë sipas kalendarit të miratuar.
2. Në zbatim të rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, ZVAP-të dhe IAP-të të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë veprimtari me përfshirjen e të gjithë nxënësve, si më poshtë:
 - a) Olimpiadat kombëtare në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë.
 - b) Pajisja me "Medaljen e artë" të nxënësve të shkëlqyer në vite.
 - c) Kampionati Kombëtar i Shahut për arsimin 9-vjeçar, në bashkëpunimin me Federatën Shqiptare të Shahut. Faza I të zhvillohet në bazë shkolle në muajin dhjetor 2024, faza II në bazë qarku në muajin shkurt, finalja në mars-prill 2025.
 - ç) Java Europiane e Sportit, 23-30 shtator 2024.
 - d) Java Olimpikë (prill-maj).
 - dh) Dita Evropiane e Gjuhëve, 26 shtator 2024.
 - e) Dita Botërore e Gjuhës Rome, UNESCO, 5 nëntor 2024.

- ë) Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve, 20 nëntor 2024.
- f) Dita e Luftës Kundër Bullizmit, 21 nëntor 2024.
- g) Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, 22 nëntor 2024.
- gj) Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, 3 dhjetor 2024.
- h) Dita e të Drejtave të Njeriut, UNESCO, 10 dhjetor 2024.
- i) Dita Ndërkombëtare e Emigrantëve, UNESCO, 18 dhjetor 2024.
- j) Dita Ndërkombëtare e Edukimit, UNESCO, 24 janar 2025.
- k) Përkujtimi i Holokaustit dhe i krimeve kundër njerëzimit, 27 janar 2025.
- l) Dita Botërore e Gjuhës Amtare, 21 shkurt 2025.
- ll) Dita Ndërkombëtare e Matematikës, UNESCO, 14 mars 2025.
- m) Dita Botërore e Poezisë, UNESCO, 21 mars 2025.
- n) Dita Botërore e Ujit, UNESCO, 22 mars 2025.
- nj) Dita Ndërkombëtare kushtuar Sportit për Zhvillim e Paqe, 6 prill 2025.
- o) Dita Ndërkombëtare e Romëve, 8 prill 2025.
- p) Dita Botërore e Librit, 23 prill 2025.
- q) Dita Ndërkombëtare e-twinning, 7 maj 2025.
- r) Dita Ndërkombëtare e Bashkëjetesës në Paqe, UNESCO, 16 maj 2025.
- rr) Dita Botërore për Diversitet Kulturor, Dialog dhe Zhvillim, UNESCO, 21 maj 2025.
- s) Dita Botërore e Mjedisit, UNESCO, 5 qershor 2025.
- sh) Dita kundër Shfrytëzimit të Punës së Fëmijëve, 12 qershor 2025.
- t) Dita Europiane e Kujtesës për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare, 23 gusht 2025.
- th) Dita Ndërkombëtare e Rinisë, UNESCO, 12 gusht 2025.
- u) Kalendarit i Ditëve të Europës dhe veprimtaritë gjithëvjetrore për njohjen e institucioneve të Bashkimit European dhe të Këshillit të Evropës.
- v) Konkursët në nivel institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, me tematikë “Të njohim Evropën”.
- y) Java Evropiane e Lëvizjes “Now we move”.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18

Institucionet që ngarkohen për marrjen e masave dhe zbatimin e këtij Udhëzimi

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore parauniversitare.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të marrin masat e duhura që ky Udhëzim të shpërndahet në çdo institucion arsimor parauniversitar dhe me përmbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i sistemit arsimor parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE
SPORTIT**

Ogerta Manastirliu



**MINISTRI I EKONOMISË
KULTURËS DHE INOVACIONIT**

Blendi Gonxhja



SHTOJCË

Plani mësimor i arsimit bazë për klasat V - IX

FUSHA/LËNDËT	KLASAT				
	V	VI	VII	VIII	IX
KURRIKULA BËRTHAMË					
GJUHET DHE KOMUNIKIMI	8	8	8	8	8
Gjuhë shqipe	5	5	5	5	5
Gjuhë e huaj e parë	3	3	3	3	3
MATEMATIKË	4	4	4	4	4
SHKENCAT E NATYRËS	2	2	4	6	6
Dituri natyre	2				
Fizikë		1	2	2	2
Kimi				2	2
Biologji		1	2	2	2
SHOQËRIA DHE MJEDISI	2	3	5	5	5
Edukim për shoqërinë					
Qytetari	1	1	1	1	1
Histori	1	1	2	2	2
Gjeografi		1	2	2	2
ARTE	2.5	3	2	2	2
Muzikë	1	1	1	1	1
Art pamor	1	1	1	1	1
Kërcim					
Teatër	0.5	1			
EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	3	3	3	3	3
TEKNOLOGJI DHE TIK	2	2	1	1	1
TIK	1	1	1	1	1
Aftësimi teknologjik praktik	1	1			
KURRIKULA ME ZGJEDHJE	2	2	2	2	2
Totali (Orë javore)	25.5	27	29	31	31